



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU  
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.  
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.  
2  
TEL: 0682027818

# VËRTETIM I NËNSHKRIMIT NË AKTET E SHOQËRIVE TREGTARE

(VËRETIM NËNSHKRIMI I MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME)

Nr. repertori: 1356

Tirane më 17/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053950097286381

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER JULIAN ZHELEGU



DATE 17/02/2021  
NR REP 1356



VËRTETIM NËNSHKRIMË

Sot, më datë 17/02/2021 (dymije e njezete e nje), para meje Noter JULIAN ZHELEGU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njesia Bashkiake nr. 5, Rr. Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr. 2, u paraqit:

**NËNSHKRUES:**

**Herion Peçi**, atësia Eduard, amësia Gjinovefa, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Rr Ali Vish; Nd. 13; H. 3; Ap. 11; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 08/11/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031579002 dhe nr. personal I11108033H; dhe

**Iljana Postol**, atësia Naum, amësia Vasilika, shtetase Shqiptare, lindur në Korçë dhe banues në KORÇË, me adresë Nasi Pendavinji 02330198; Nd. 4; H. 1; Korçë; Korçë; 7001; Korçë, lindur më 04/08/1988, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034264327 dhe nr. personal I85804066W;

te cilet deklaruan se kane nenshkruar me vullnet te lire e te plote ne cilesine e ortakeve te shoqerise "Activ Fitness" Shpk, **Statut i shoqerise "Activ Fitness" Shpk me date 17.02.2021.**

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

JULIAN ZHELEGU



JULIAN ZHELEGU  
NOTER/NOTARY PUBLIC  
NIP/TIN/VAT no. - K61717003K  
Address: Rr. Pjeter Bogdani, nr. 13, K. 1  
Tirana - ALBANIA  
Tel./Fax: +355042255528  
E-mail: noteri@studiozhelegu.net



STATUT I SHOQERISE  
"ACTIV FITNESS" Sh.P.K.

*Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.*

Sot, me date 17/02/2021 (dymije e njetete e nje) personat e meposhtem:

Z. Herion Peçi, shtetas shqiptar, lindur me 08/11/1981 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 031579002 dhe nr. personal I11108033H, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; dhe

Znj. Iljana Postol, shtetase shqiptare, lindur me 04/08/1988 ne Korçe e banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. 034264327 dhe nr. personal I85804066W, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar;

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 17/02/2021 ne, themeluesit e mesiperme, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar "ACTIV FITNESS" SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- ***Palester, Wellness Center;***
- ***Qender sportive dhe pergatitje fizike ne palester me programe aerobike, fitnesi, baleti, etj, Veprimtari ne fushen e mirembajtjes fizike, esketike dhe shendetesore te trupit per te gjitha moshat, nepermjet makinerive te Fitnesit dhe ushtrimeve dhe kercimit, etj. Import eksport dhe tregtim i pajisjeve per ushtrime fizike dhe i pajisjeve te tjera te te gjitha llojeve si dhe trajnimi per perdorimin e pajisjeve si dhe import- eksport dhe tregtim te te gjitha produkteve te tjera qe lejohen ne qarkullimin civil ne vend,***
- ***Ne funksion te qellimeve te mesiperme Shoqeria mund te hyje ne tregje dhe operatione te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajshme e te paluajshme dhe/ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare.***

Neni 3  
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.



Neni 4  
Selia

- Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:  
*Njesi me nr. pasurie 3/40+1-N2, me sipërfaqe 170 m2 (njqind e shtatedhjete metra katrore), e ndodhur ne zonen kadastrale 8270, volumi 42, faqe 34, me adrese Apartamenti N2, Tirane;*

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II  
Kapitali

Neni 5  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Herion Peçi: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 75.000 LEK që përben 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortakja themeluese Iljana Postol: Zoteruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25.000 LEK që përben 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve është në para.

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni 6  
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve si dhe nëpërmjet trashëgimisë.

Çdo transferim i pjeseve të kapitalit ndaj personave të treta, në çfarëdo mënyre, si dhe krijimi i çdo të drejte reale apo garancie mbi pjesët e kapitalit në favor të paleve të treta, duhet të miratohet paraprakisht nga Asambleja e Ortakeve, në të kundërt do të jetë i pavlefshëm.

Secili ortak ka të drejten e parablerjes në rast transferimi të pjeseve të kapitalit të ortakëve të tjerë. Ortaku transferues detyrohet të njoftojë të gjithë ortakët e tjerë në lidhje me kushtet thelbësore të transferimit dhe t'i japë atyre një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh për të vendosur nëse do të ushtrojnë apo jo të drejtat e tyre të parablerjes. Ortaket që vendosin të ushtrojnë të drejten e parablerjes duhet të njoftojnë ortakun transferues brenda afatit të mesiperm. Me kalimin e afatit të mesiperm, ortakët që nuk kanë njoftuar ushtrimin ose jo të së drejtës së parablerjes, do të prezumohet se nuk dëshirojnë ta ushtrojnë atë. Në varesi të numrit të ortakëve që ushtrojnë ose jo të drejten e parablerjes, me mbarimin e afatit 30 ditor, secili ortak do të fitojë proporcionalisht me pjesët e zoteruara prej tij, pjesët e kapitalit që transferohen nga ortaku transferues. Nëse asnjë ortak nuk ushtron të drejten e parablerjes, ortaku transferues mund t'i transferojë pjesët e kapitalit në favor të çdo personi të treta në të njëjtat kushte esenciale me ato të ofruara ortakëve të tjerë si me sipër.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

## Neni 8

### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9

##### Mënyra e Thirrjes se

##### Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 51 perqind te kuotave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 12

### Përgjithshmi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Z. Herion Peçi**, shtetas shqiptar, lindur me 08/11/1981 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me nr. 031579002 dhe nr. personal I11108033H, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, nr. kontakti: 0696430679, *pa kufizime në kompetencat e administrimit.*

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecërisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asambletë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;







d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

#### Viti financiar-ekspertet

#### Neni 16

#### Viti Financiar


Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 17

#### Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar me bazen e të drejtes vendimore qe ka.



#### Kreu V

#### Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

#### Neni 18

#### Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

#### Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

#### Neni 20

#### Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtarët dhe shoqërite tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 21

#### Mosmarrëveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.



Depozitimi dhe regjistrimi i ketij Statuti te shoqerise "Activ Fitness" Shpk ne Qendren Kombetare te Biznesit do te behet nga ortaku dhe administratori i shoqerise Z. Herion Peçi, shtetas shqiptar, lindur me 08/11/1981 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me nr. 031579002 dhe nr. personal I11108033H, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT  
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"ACTIV FITNESS" Sh.P.K.

Znj. Iljana Postol

Iljana Postol

Z. Herion Peçi

Herion Peçi